

VENDIM
Nr. 38, datë 18.3.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK PËR
LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Dokumentacioni i përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b”, “c”, dokumentacioni teknik është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti